



---

**VENDIM**

**Nr. 93 Datë 30.11.2010**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË ULJES SE HUMBJEVE TOTALE  
PER TRE PERIUDHAT E RREGULLIMIT**

Në mbështetje të nenin 9 të ligjit nr. 9072 date 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, pikës 4.5 të Deklarates Rregullatore, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve nr.12 date 03.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.11.2010, mbasi analizoi propozimin e riskedulimit të programit të uljes së humbjeve totale të propozuar nga CEZ Shperndarje sh.a dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtës së Konsumatorit

**Vendosi:**

- 1- Të miratojë programin e uljes së humbjeve për të tre periudhat e rregullimit sipas skedulit të mëposhtem:
  - 6 % ulje kumulative për periudhën e parë të rregullimit 1 janar – 31 dhjetor 2010 dhe për periudhën e dytë të rregullimit 1 janar -31 dhjetor 2011.
  - 11 % ulje për periudhën e tretë të rregullimit 1 janar 2012 – 31 dhjetor 2014 në përputhje me planin e investimeve që do të miratohet për kompaninë nga ERE për periudhën përkatëse.
- 2- Ngarkohet CEZ Shperndarje për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

# Bujar NEPRAVISHTA

---

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta"10  
Tirane  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22 963  
Tel +355 42 69 590  
[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)